



VENDIM

Nr.10 Datë 18.02.2011

**PËR
MOSPRANIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ALBANIAN
CHROME” PËR MARRJEN E STATUSIT TË KLIENTIT TARIFOR**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 7 dhe 8 të “Rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.99, datë 27.12.2006, pikës 7, gërma “a” të Modelit Shqiptar të Tregut, miratuar me VKM nr. 338, datë 19.03.2009 dhe pikës IV.2 të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike miratuar me vendimin nr.68, datë 23.06.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 18.02.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian Chrome”, për heqjen e statusit të klientit të kualifikuar dhe rikthimin në statusin e Klientit Tarifor,

Konstatohet se :

- Së pari: Aplikimi për kthimin e “Albanian Chrome” në statusin e Klientit Tarifor nga data 1 Shkurt 2011, nuk i plotëson kërkesat e Rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të Klientit të Kualifikuar si dhe Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, pasi kërkesa nuk është paraqitur në respektim të afateve të përcaktuara nga këto Rregullore.
- Së dyti: Kalimi i “Albanian Chrome” nga Klient i Kualifikuar në Klient Tarifor sipas vendimit nr. 100, datë 07.12.2010, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nuk është i mundshëm pasi kthimi i tij në Klient Tarifor do të sillte kosto të reja shtesë për KESH sh.a si dhe do të cenonte sigurinë e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët tariforë, nëse këto kosto nuk do të mbulohen nga KESH sh.a nëpërmjet tarifës së furnizimit më shumicë të energjisë elektrike për këtë konsumator.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos miratojë kërkesën e shoqërisë “Albanian Chrome” për marrjen e statusit të Klientit Tarifor sipas kërkesës së tij për kthimin në Klient Tarifor



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



nga data 1 Shkurt 2011, dhe sipas çmimeve të miratuara nga ERE me Vendimin nr. 100, datë 07.12.2010.

2. “Albanian Chrome” mund të aplikojë për marrjen e statusit të Klientit Tarifor në pëpruthje me kriteret siç përcaktohen në Rregulloren për Kriteret e Dhënies dhe Heqjes së Statusit të Klientit të Kualifikuar dhe Rregullat e Tregut, me një çmimi shtesë siç mund të përcaktohet nga ERE.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë “Albanian Chrome” për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr.10 Datë 18.02.2011

**PËR
MOSPRANIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ALBANIAN
CHROME” PËR MARRJEN E STATUSIT TË KLIENTIT TARIFOR**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____